



Federal Ministry for the
Environment, Nature Conservation,
Building and Nuclear Safety

Umwelt
Bundesamt

FUQIA ËSHTË NË DUART E TUA

DORACAK PËR QYTETARËT DHE
ORGANIZATAT QYTETARE

për
Protokollin e regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të
ndotësve



Република Македонија
Министерство за животна средина
и просторно планирање



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER

FUQIA ËSHTË NË DUART E TUA

DORACAK PËR QYTETARËT DHE
ORGANIZATAT QYTETARE

për
Protokollin e regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve

Shkup, Maqedoni
Prill 2017

Përmbajtja e plotë e këtij botimi është e drejtë autoriale.
© 2017 Qendra Rajonale e Mjedisit për Europën Qendrore dhe Lindore Asnjë pjesë
e këtij botimi nuk guxon të shitet në asnjë formë apo të shumëzohet për shitje pa
lejen paraprake me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.



Република Македонија
Министерство за животна средина
и просторно планирање



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER

PËR REC

Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) është një organizatë ndërkombëtare me një mision për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve mjedisore. REC e përmbush misionin e saj përmes promovimit të bashkëpunimit ndërmjet qeverive, organizatave joqeveritare, komunitetit të biznesit dhe faktorëve të tjerë shoqërorë në fushën e mjedisit dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacioneve dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset vendimmarrëse nga sfera e mjedisit jetësor.

REC është themeluar në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria. REC ligjërisht është themeluar në kuadër të kartës me më shumë se 30 nënshkrues. Organizata mbështetet në një rrjet të zyrave dhe ekspertëve në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe më gjerë. Zyra kryesore ndodhet në Sentendre të Hungarisë.

REC merr pjesë në mënyrë aktive në proceset kryesore globale, rajonale dhe lokale dhe kontribuon në mjedisin jetësor dhe zgjidhjet e qëndrueshme në kuadër të zyrave lokale dhe përtej rrjetit të tyre, duke transferuar njohuritë dhe përvojën që mund të përhapen në vend dhe rajon.

Donatorët e fundit janë Komisioni Evropian, mekanizmat financiare të Zonës Ekonomike Evropiane (EEA) ose (Norvegjia, Islanda, Lihtenshtajni), Kombet e Bashkuara, qeveritë e Shqipërisë, Austrisë, Azerbajxhanit, Bosnjës dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Finlandës, Gjermanisë, Hungarisë, Italisë, Japonisë, Malit të Zi, Holandës, Norvegjisë, Polonisë, Serbisë, Sllovenisë, Suedisë, Zvicrës, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe organizata të tjera ndërkombëtare, banka dhe kompani.

Përgatitur nga:

- mr. Metodija Dimovski

Me kontribut të:

**- Azemine Shakiri, person përgjegjës i
RSHTN-së,
Qendra Informativ e Maqedonisë për
Mjedisin Jetësor,
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ,**

- Ekipi i projektit të REC

Botimi është përgatitur në kuadër të projektit "Mbështetja e krijimit dhe përmirësimit të Protokollit për Regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve (RSHTN) në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Moldavi ",financuar nga Programi i ndihmës këshillëdhënëse (AAR) për mbrojtjen e mjedisit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, Kaukazit dhe Azisë Qendrore dhe fqinjët e tjerë të Bashkimit Evropian, në Ministrinë federale gjermane për mjedisin, ruajtjen e natyrës, ndërtesave dhe siguri bërthamore. Projekti mbikëqyret nga Agjencia gjermane e Mjedisit (UBA). Projekti u zbatua në periudhën prill 2015 - prill 2017 nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) në bashkëpunim me personat përgjegjës kombëtarë për RSHTN, partnerë të tjerë nga vendet, si dhe me mbështetjen këshillëdhënëse të Sekretariatit për Protokollin e RSHTN-së në UNECE .

Informacioni është fuqi, ndërsa informacioni për mjedisin në duart e publikut i mundëson atij të luajë një rol të rëndësishëm në formësimin e një të ardhme të qëndrueshme. Shumë shpesh njerëzit janë lënë në errësirë për vendimet që mund të çojnë në katastrofa ekologjike dhe në degradimin e mjedisit, duke ndikuar në jetën e tyre dhe në jetën e brezave që do të vijnë.

Jit Peters

Kryetar i Takimit të
Palëve të Konventës së Aarhusit
25 qershor 2014

PARATHËNIE

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë, nëpërmjet Konventës së Aarhusit, kanë të drejtën e garantuar për qasje në informata dhe të dhëna mbi mjedisin, të drejtën për të pjesëmarrje në vendimmarrje në lidhje me mjedisin dhe qasjen në drejtësi nëpërmjet institucioneve.

Ata qytetarë, të cilët janë të informuar mirë për gjendjen dhe cilësinë e mjedisit janë të vetëdijshëm për sfidat që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, rreziqet shëndetësore për shkak të ndotjes së shumicës së mediave në mjedis, si dhe nevojën për të ndërmarrë hapat e duhur drejt zbatimit me kohë të legjislacionit përkatës. Qytetarët e informuar janë iniciatorë dhe promotorë të përgjegjësishë shoqërore dhe mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit.

Me qëllim të përmbushjes së të drejtave të qytetarëve, Qendra Informativë e Maqedonisë për Mjedisin Jetësor krijoi, mirëmbanë dhe rregullisht azhurnon të ashtuquajturin Regjistër të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve (RSHTN) - si një shërbim përmes të cilit publiku ka qasje në informacione dhe të dhëna për ndotjen që shkarkohet nga sektori industrial në Republikën e Maqedonisë. Në këtë mënyrë, qytetarët, bizneset, institucionet dhe faktorë të tjerë socialë, kanë mundësi për qasje në informacione në kohë, relevante dhe të besueshme, në aspektin e ndotjes nga sektori industrial.

Në parim, qasja në këto informacione lejon fillimin e një procesi informues të bashkëpunimit të qytetarëve me institucionet përkatëse, ngritjen e vetëdijes publike në lidhje me situatën me ndotjen nga industria dhe afrimin e publikut me idenë e ndërtimit të një marrëdhënie të përgjegjshme dhe të qëndrueshme me mjedisin.

Për këtë qëllim, ky botim do të sigurojë një hyrje të shkurtër në Rregulloren, Protokollin dhe Regjistrin e shkarkimit dhe transferimit (RSHTN) të ndotësve, si dhe udhëzimet se si qytetarët mund të ndikojnë në zbatimin e Protokollit në Republikën e Maqedonisë. Në këtë mënyrë, qytetarët mund të kontribuojnë drejtpërsëdrejti në reduktimin e ndotjes dhe në mbrojtjen më efektive të mjedisit.

**Qendra Informativë e Maqedonisë për Mjedisin Jetësor
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor**

PËRMBAJTJA

Parathënie	v
Përmbajtja	vi
1 Historia e shkurtër e RSHTN-së	6
1.1 Fillimi idesë.....	6
1.2 Protokollin e Kievit për RIPZ dhe Konventa e Aarhusit.....	8
1.2.1 Statusi i ratifikimit të Konventës dhe Protokollit	10
2 Protokollin e Kievit për RSHTN-në.....	11
2.1 Qëllimi i Protokollit për RSHTN.....	11
2.2 Përmbajtja dhe struktura e sistemeve të RSHTN-së	11
2.3 Njoftim, grumbullim dhe vlerësim i cilësisë së të dhënave	13
2.4 Pjesëmarrja e publikut.....	13
2.5 Korniza organizative/administrative dhe institucionale e Protokollit të RSHTN-së	14
3 RSHTN dhe shoqëria qytetare.....	16
3.1 Cili është përfitimi i publikut nga ekzistimi i sistemeve të RSHTN-së?	16
3.2 Si mund të kyçen OJQ-të në procesin e RSHTN-së?.....	17
4 Sistemi i RSHTN-së i Bashkimit Evropian.....	19
4.1 E-ПРТР и Киевскиот РИПЗ	22
5 Sistemi i RSHTN-së në Republikën e Maqedonisë	23
5.1 Ueb-portali kombëtar i RSHTN-së	27
6 Lidhje të rëndësishme dhe burime informacioni	30
7 Lista e shkurtesave të përdorura	3
2	
8 Lista e grafikëve, fotografive dhe kornizave.....	33

1. HISTORIA E SHKURTËR E RSHTN-së

1.1. Fillimi i idesë

Regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve janë në fakt sisteme të thjeshta për grumbullimin dhe shkëmbimin e informacionit rreth mjedisit që kanë të bëjnë me shkarkimin dhe transferimin e kimikateve të dëmshme dhe helmuese që vijnë nga ndërmarrjet industriale dhe të tjera .

Ideja e krijimit të sistemeve të tilla paraqitet në mes të viteve të tetëdhjeta të shekullit XX , pas një prej katastrofave më të mëdha industriale në botë, e cila ndodhi në vitin 1984 në Bhopal të Indisë.

Njohja e parë globale e nevojës për të informuar publikun për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve u bë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin, mbajtur në Rio në vitin 1992.

Në fakt, për herë të parë, këtu është afirmuar parimi "E drejta për të ditur", por edhe më shumë, në këtë Samit, vendet pjesëmarrëse kanë hedhur themelet e sistemeve të RSHTN-së, të cilat duhet të jenë të disponueshme dhe të lira publikisht dhe të përmbajnë informacion mbi sasinë e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve nga ndërmarrjet e mëdha industriale, të cilat janë të detyruara të sigurojnë informacion të tillë.

Por miratimit të Protokollit të RSHTN-së i kishin paraprirë disa aktivitete të rëndësishme. Së pari, në vitin 1996, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) miratoi rekomandime për

zbatimin e RSHTN-së, duke u kërkuar shteteve të saj anëtare, të krijojnë baza të tilla të të dhënave duke bashkëpunuar me industrinë dhe publikun, dhe më vonë një Udhëzues praktik për qeveritë.

1. Qasja në informata: Çdo qytetar duhet të ketë të drejtën për të pasur qasje të lehtë në informacionin për mjedisin jetësor. Autoritetet publike duhet të sigurojnë të gjitha informacionet e nevojshme dhe t'i mbledhin dhe shpërndajnë në mënyrë të duhur dhe transparente. Ata mund të refuzojnë ta bëjnë këtë, vetëm në situata të caktuara të justifikuara, kur dhënia e informacionit mund të ndikojë negativisht. Megjithatë, duhet të sigurohen gjithmonë informacione për shkarkimet e ndotësve mjedisorë.

2. Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen për mjedisin jetësor: Publiku duhet të informohet për të gjitha nismat relevante dhe duhet të jetë në gjendje të marrë pjesë që nga fillimi i procedurave për marrjen e vendimeve për aktivitete specifike (për shembull: licencat, lejet), si dhe për planet, programet, politikat dhe aktet ligjore.

3. Qasja në drejtësi për çështjet mjedisore: Publiku ka të drejtën e një procesi gjyqësor ose administrativ në rast se Pala shkel të drejtën e qasjes në informacion dhe pjesëmarrjen e publikut ose nuk i përmbahet rregullave kombëtare të mjedisit dhe parimeve të Konventës.

**NGJARJE RELEVANTE QË I PARAPRIJNË
PROTOKOLLIT TË KIEVIT**

1984	Fatkeqësia industriale në Bhopal, Indi. Rrjedhja e gazit (metilizocianat) ka kërcënuar më shumë se gjysmë milioni njerëz.
1992	Samiti për planetin Tokë, Rio, Brazil. Parimi 10 çështjet mjedisore trajtohen më së miri me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara. Vendet pjesëmarrëse kanë hedhur themelet e sistemeve të RSHTN-së.
1996	OECD miraton rekomandime për zbatimin e RSHTN-së dhe i fton shtetet anëtare të krijojnë baza të tilla të të dhënave në bashkëpunim me industrinë dhe publikun.
1998	Konventa e Aarhus-it u miratua në Konferencën e katërt ministrore nga procesi “Mjedis Jetësor për Evropën”. Konventa parashikon mundësinë e krijimit të një sistemi kombëtar të RSHTN-së, dhe mundësinë e zhvillimit të një instrumenti ndërkombëtar.
2000	NGJARJE RELEVANTE PËR PROTOKOLLIN E KIEVIT
2001	Komiteti i politikave mjedisore i KB-ve EKE ka formuar një Grup punues të RSHTN-së për të përgatitur një instrument ligjërisht detyrues. Në vitin 2002 Grupi i punës vazhdon të punojë nën patronazhin e MoP të Konventës së Aarhusit.
2009	Protokolli i Kievit për RSHTN-në është miratuar në Konferencën e pestë ministrore nga procesi “Mjedis Jetësor për Evropën”.
2010	Më 8 tetor 2009, hyri në fuqi Protokolli i Kievit për RSHTN-në.
2016	Më 2 tetor 2010, Republika e Maqedonisë u bë anëtare e Protokollit të Kievit për RSHTN-në.

Në të njëjtën kohë, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (BE EKE) fillon me përgatitjen e një prej marrëveshjeve më të njohura ndërkombëtare në fushën e mjedisit, që është Konventa për Qasjen në informata, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore, që do të bëhet e njohur si Konventa e Aarhusit, sipas emrit të qytetit të Aarhusit në Danimarkë, ku në vitin 1998 u miratua në Konferencën e katërt ministrore të procesit "Mjedis Jetësor për Evropën".

1.2. Protokollin e Kievit për RSHTN dhe Konventa e Aarhusit

Konventa e Aarhusit ka krijuar tri shtyllat për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore.

Këtu duhet theksuar një moment interesant. gjegjësisht, Konventa e Aarhusit bën dallim midis nocioneve "publicitet", ku përmenden të gjitha palët e interesuara të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe qytetarët dhe "publikun e interesuar" ku janë përfshirë qytetarët ose organizatat publike dhe subjekte tjera të interesuara, të cilët janë të prekur ose mund të ndikohen, ose që kanë një interes në vendimmarrje, të tilla siç janë OJQ-të mjedisore. Konventa merr në konsideratë veçanërisht ato OJQ mjedisore që punojnë për të promovuar mjedisin jetësor.

Por, pse është e rëndësishme konventa Aarhus-it për RSHTN-në? Meqë kjo Konventë,

jo vetëm që përmes tri shtyllave të saj, në praktikë zbatoi parimet e Deklaratës së Rio-s, por shkoi një hap më tej në sistemet e RSHTN-së dhe të "E drejta për të ditur".

Në frymën e Konventës, qysh gjatë përpunimit të saj, jo vetëm që është parashikuar mundësia e krijimit të një sistemi kombëtar për RSHTN, por dhe mundësia për përgatitjen e një marrëveshjeje të përshtatshme ndërkombëtare, me të cilën detajisht do të rregullohet kjo çështje

Në nenin 5, paragrafi 9 (korniza 1) e Konventës, parashihet që Palët në Konventë (këto janë shtetet që me ratifikimin e Konventës ose Protokollit janë bërë anëtare të këtyre marrëveshjeve

KORNIZA GRUMBULLIM DHE PUBLIKIM I NR.1. INFORMACIONEVE PËR MJEDISIN

Neni 5 paragrafi 9. Duke marrë parasysh proceset përkatëse ndërkombëtare, secila Palë do të marrë masa për të vendosur gradualisht një sistem kombëtar gjithëpërfshirës të inventarëve ose regjistrave të ndotësve, në një bazë të dhënash strukturore, të kompjuterizuara dhe të disponueshme, e konceptuar me ndihmën e dërgimit të standardizuar të raporteve.

Një sistem i tillë mund të përmbajë të dhëna dhe transfere për përfshirje precize të substancave dhe produkteve, përfshirë përdorimin (shfrytëzimin) e ujit, energjisë dhe burimeve, nga një fushë e caktuar e aktiviteteve në mediumet e mjedisit mjedisor dhe në vendet e pastrimit dhe deponimit .

ndërkombëtare), do të krijojnë sistem të tillë kombëtar gjithëpërfshirës të regjistrave për ndotësit.

Për të mos mbetur një dispozitë e tillë, vetëm në letër, në nenin 10 paragrafi 2 (3) (korniza nr. 2), Konventa përcaktoi se Palët, në mbledhjen e parë, do të shqyrtojnë se si zbatohet detyrimi sipas nenit 5 paragrafi 9 dhe, nëse është e nevojshme, do të marrin vendim për përgatitjen e një instrumenti të përshtatshëm.

Është e rëndësishme të thuhet se përfshirja e RSHTN-së në Konventë fillimisht ishte propozuar nga Koalicioni i OJQ-ve, që më vonë formuan EkoForum, si Koalicion i organizatave qytetare mjedisore dhe OJQ-të tjera që veprojnë në rajonin e KB EKE, kryesisht të fokusuar në procesin ministror "Mjedisi jetësor për Evropën". Më vonë, ky Koalicion ishte përfshirë në mënyrë aktive në përgatitjen e Protokollit të RSHT-së si pjesë e grupit ndërqeveritar të punës që hartoi Protokollin.

KORNIZA TAKIMI I PALËVE NR. 2.

Neni 10 paragrafi 2(3). Në mbledhjen e tyre të parë do të shqyrtojnë përvojat e tyre nga zbatimi i dispozitave të nenit 5 paragrafi 9 dhe do të vendosin se cilat hapa janë të domosdoshëm për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit në këtë drejtim, duke pasur parasysh proceset dhe tendencat ndërkombëtare dhe duke përfshirë edhe përgatitjen e një instrumenti të përshtatshëm që ka të bëjë me regjistrat ose inventarët në lidhje me lirimin e ndotjes dhe transferimin e saj, të cilat mund të organizohen si shtojcë e kësaj Konvente.

Në bazë të analizave të kryera për zbatimin e Konventës, në Mbledhjen e parë të Palëve u mor vendimi, me të cilin filloi zyrtarisht procesi për përgatitjen e Protokollit për RSHTN-në.

Protokolli i RSHTN-së është protokollin e parë dhe i vetëm që rrjedh nga Konventa e Aarhus-it. Është përgatitur nga një grup pune shumëpalësh, i cili paraprakisht ka punuar nën patronazhin e Komitetit të Politikave Mjedisore të KB EKE dhe në Takimin e Parë të Palëve të Konventës (Luka, Itali, 21-23 tetor 2002) u zëvendësua nga Grupi Punues për RSHTN-në. Ky grup pune është i detyruar të përgatisë tekstin e protokollit të instrumenteve ligjërish detyrues, më së voni deri në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Palëve, të mbajtur në Kiev më 23 maj 2003.

1.2.1. Statusi i ratifikimit të Konventës dhe Protokollit

Konventa e Aarhus-it u miratua në vitin 1998 në Konferencën e katërt ministrore në kuadër të procesit "Mjedisi jetësor për Evropën", i cili ishte nën kujdesin e KB EKE dhe hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Protokolli i Kievit për RSHTN-në, nga ana tjetër, u miratua më 2003 në Konferencën e pestë ministrore në kuadër të procesit "Mjedisi jetësor për Evropën", dhe hyri në fuqi më 8 tetor 2009.

Deri më 20 maj 2016, Konventa Aarhus-it ka 47 Palë, ndërsa Protokollin për Regjistrimin dhe Transferimin e Ndotësve (RSHTN) ka 35 Palë.

Megjithëse i miratuar zyrtarisht në Rajonin e KB EKE, Protokollin ka një karakter global dhe është i hapur për shtetet që ndodhen jashtë Evropës, si dhe për ato që nuk janë anëtare të Konventës.

Republika e Maqedonisë ka ratifikuar Konventën e Aarhusit dhe që prej datës 22 korrik 1999 ka statusin e vendit të Konventës, ndërsa për Protokollin mbi RSHTN-në statusin e të tillë e ka marrë nga 2 tetori 2010.

2. PROTOKOLLI I KIEVIT PËR RSHTN

Protokolli i RSHTN-së përbëhet nga një preambulë, 30 nene dhe katër anekse.

Në Preambulë është paraqitur baza ligjore për miratimin e Protokollit (shih Kapitullin 2 të këtij dokumenti), si dhe kriteret e tjera historike, si dhe parimet e politikave të mbrojtjes së mjedisit, si dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje .

Tri anekset e para të Protokollit kanë një karakter teknik dhe identifikojnë aktivitetet dhe ndotësit që do të jenë subjekt i raportimit në sistemet kombëtare të RSHTN-së. Më shumë detaje mbi përmbajtjen e anekseve janë paraqitur në Kapitujt 3 dhe 4 të kësaj broshure. Ndërsa, aneksi i katërt ka një karakter administrativ dhe ka të bëjë me arbitrazhin, gjegjësisht, përpunon nenin 23 paragrafi 2 të Protokollit.

2.1. Qëllimi i Protokollit të RSHTN

Tre artikujt e parë paraqesin objektivat e Protokollit, japin përkufizime të termave të caktuara të përdorura në Protokoll, si dhe disa dispozita të përgjithshme.

Qëllimi i Protokollit është "për të forcuar qasjen e publikut në informata duke krijuar regjistra koherentë kombëtarë për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve (RSHTN) ... që mund të lehtësojnë pjesëmarrjen e publikut në marrjen e vendimeve për mjedisin jetësor dhe të kontribuojnë në parandalimin dhe reduktimin e ndotjes të mjedisit jetësor (neni 1 i Protokollit).

Me fjalë të tjera, qëllimi më i rëndësishëm i Protokollit të RSHTN-së është e drejta e publikut për të ditur, gjegjësisht, ai përpiqet t'i vendosë ato

të dhëna të ndotjes në dispozicion të publikut nëpërmjet regjistrave kombëtarë të disponueshëm publik, me qëllim që të ndihmojë pjesëmarrjen e publikut, por edhe për të zvogëluar dhe parandaluar ndotjen.

Në fakt, detyrimet e raportimit të operatorëve duhet t'u mundësojnë atyre të rrisin njohuritë e tyre për mjedisin, të përmirësojnë menaxhimin e mjedisit, dhe kështu të kontribuojnë në parandalimin dhe reduktimin e ndotjes.

2.2. Përmbajtja edhe struktura e sisemeve të RSHTN

Nenet 4 deri 6 përshkruajnë elementet (Grafiku 2), strukturën dhe fushëveprimin e sistemeve të RSHTN-së.

RSHTN është, në fakt, një inventar i ndotësve të shkarkuar nga burimet të caktuara, siç janë industritë apo burimet e mëdha bujqësore, por edhe nga burime të tjera të shpërndara, si bujqësia ose trafiku.

Sistemet kombëtare të RSHTN-së duhet të jenë në dispozicion të publikut në internet, për të mundësuar kërkimin dhe për të qenë të lehtë për përdoruesit. Sisteme të tilla duhet gjithashtu të kenë një kufizim të besueshmërisë, por gjithashtu të mundësojnë pjesëmarrjen e publikut në zhvillimin dhe ndryshimin e tyre.


Në lidhje me publikun, shumë është me rëndësi dispozita e nenit 5 paragrafi 1 i Protokollit, i cili i referohet kërkimit të bazës së të dhënave. Në fakt, Protokollit përcakton standardin që sistemet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit të secilit vend duhet ta përmbushin, që do të thotë shfaqja e të dhënave për shkarkimin dhe transmetimin në formë agregate dhe jo- agregate dhe mundësi

për kërkim sipas :

- Instalimit dhe lokacionit gjeografik,
- Aktivitetit / veprimtarisë,
- Pronarit ose operatorit dhe kompanisë,
- Substancat ndotëse ose mbeturinat,
- Mediumet e mjedisit jetësor, dhe
- Lokacionit të transferimit.

GRAFIKU NR. 2.

ELEMENTE TË SISTEMEVE TË RSHTN



2.3. Njoftim, grumbullim dhe vlerësim i cilësisë së të dhënave

Nenet 7 deri 10 do të përshkruajnë dispozitat që lidhen me njoftimin nga pronarët, gjegjësisht operatorët e instalimeve. Në esencë skemat e sistemeve të RSHTN-së janë themeluar në bazë të skemave për njoftim, të cilat në secilin shtet janë të detyrueshme, periodike, specifike / vjetore për çdo instalim, për çdo ndotës dhe i mbulojnë emetimet në ajër, ujë, ujërat e ndotura, tokë dhe transferimin e mbeturinave. Në këtë mënyrë, Protokollin në fakt paraqet detyrime të drejtpërdrejta për kompanitë private dhe publike çdo vit ta njoftojn organin kompetent për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve të tyre.

Por Protokollin i RSHTN-së i paraqet vetëm kërkesat minimale, ndërsa palët janë të lira të fusin instalime dhe subsatanca tjera ndotëse, duke pasqyruar situatën specifike dhe kushtet, siç është rasti me sistemin kombëtar të RSHTN-së në Republikën e Maqedonisë.

Protokollin gjithashtu kërkon nga Palët t'i përcaktojnë edhe organet kompetente të cilat do t'i grumbullojnë informatat për shkarkimin e substancave ndotëse nga burimet difuze për të cilat tanimë janë grumbulluar të dhënat ose praktikisht mund të kyçen në sistem.

Përfundimisht, Protokollin e rregullon edhe çështjen e cilësisë që për obligim e kanë pronarët/operatorët e instalimeve si dhe organet kompetente, sidomos në lidhje me të dhënat komplete, të besueshme dhe konsekuente.

2.4. Pjesëmarrja e publikut

Nenet 11 deri 15 të Protokollit të RTSHN-së kanë të bëjnë me publikun dhe pjesëmarrjen e saj në krijimin e sistemeve, në përdorimin e të dhënave, qasjen në drejtësi dhe në çështje të tjera.

Në këtë pjesë, dispozitat e protokollit ndjekin parimet e Konventës së Aarhusit. Neni 11 përcakton se Palët janë të detyruara t'i sigurojnë publikut qasje të lirë dhe të hapur dhe shfrytëzim të të dhënave nga regjistri përmes rrugës elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur atëherë një qasje e tillë duhet të sigurohet me kërkesë të publikut, për çka mund të paguhet kompensim, por vetëm për kostot materiale (për shtypjen, kopjimin, etj.).

Në nenin 12, Protokollin gjithashtu rregullon çështjen e besueshmërisë së të dhënave në RSHTN-në, por thekson se besueshmëria duhet të interpretohet në mënyrë kufizuese, duke pasur parasysh interesin publik dhe nëse këto të dhëna / informacione lidhen me shkarkimet në mjedisin jetësor. Këto dispozita të Protokollit qartë tregojnë se çdo informacion i të dhënave / shkarkimit që është i rëndësishëm për mjedisin do të jetë subjekt i disponueshmërisë në përputhje me ligjin kombëtar. Nëse, megjithatë, të dhënat / informatat mbeten konfidenciale, regjistri duhet të tregojë se çfarë lloj të dhënash nuk janë të disponueshme dhe, nëse është e mundur, të japë një informacion të përgjithshëm mbi përbërjen kimike, për shembull.

Dispozitat e Nenit 13 janë shumë të rëndësishme për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe krijimin e sistemeve të RSHTN-së, si dhe ndryshimet e mundshme në to.

Neni 14 trajton çështjen e qasjes në drejtësi, duke i detyruar palët të sigurojnë në legjislacionin e tyre kombëtar një procedurë inspektimi, sipas të cilës secili

person i cili beson se e drejta e tij / saj për qasje të lirë është shkelur do të jetë në gjendje të kërkojë mbrojtje në gjykatë ose para një organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm të themeluar me ligj.

Protokolli gjithashtu merr parasysh kapacitetin e publikut për të përdorur të gjitha mundësitë në lidhje me RSHTN-në, të cilat janë përcaktuara me Protokoll. Prandaj, me nenin 15, të gjitha palët janë të detyruara të promovojnë vazhdimisht vetëdijen publike për ekzistencën e sistemit kombëtar RSHTN, por gjithashtu të ofrojnë ndihmë dhe udhëzime për qasje në sistemet e tilla dhe përdorimin e të dhënave prej tyre, gjegjësisht të punojnë në zhvillimin e kapaciteteve të publikut.

2.5 Korniza administrative dhe institucionale / organizative e Protokollit të RSHTN

Pesëmbëdhjetë anëtarët e tjerë të Protokollit të RSHTN-së janë të përkushtuar në rregullimin e shumë çështjeve administrative, organizative, institucionale dhe të tjera, të cilat janë të domosdoshme për çdo marrëveshje shumëpalëshe ndërkombëtare, siç është në fakt ky Protokoll. Këto përfshijnë si në vijim:

- Bashkëpunim ndërkombëtar - Protokollit kërkon nga Palët të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në zbatimin e tij, të shkëmbejnë të dhëna dhe informacione, transferim të teknologjive dhe kështu me radhë.
- Pozitë institucionale / organizative

Trupi më i lartë drejtues i Protokollit është Mbledhja e Palëve (MoP). Ajo përbëhet nga të gjitha Palët e Protokollit, domethënë të gjitha vendet dhe organizatat ekonomike rajonale që kanë ratifikuar ose miratuar Protokollin, duke fituar kështu të drejtën për të votuar ose për të vendosur. Të gjithë nënshkruesit e tjerë, shtetet, organizatat joqeveritare dhe palët e tjera të interesuara marrin pjesë në punën e MoP, por si vëzhgues.

Mbledhjet e MoP mbahen së bashku me sesionet e Konventës së Aarhus-it. Deri më tani janë mbajtur dy seanca të MoP - Seanca e parë u mbajt në Gjenevë, Zvicër, nga 20 deri më 22 prill 2010 dhe e dyta në Mاستriht, Holandë, nga 2-4 korrik 2014.

MoP kujdeset për zbatimin e Protokollit



Fotografia nr.1

Konventa e Aarhusit MoP-5 dhe MoP-2 RSHTN, Mاستriht, 2014

dhe sipas nevojës mund të marrë masat e duhura. Puna e tij rregullohet me Nenin 17 të Protokollit, si dhe me Rregulloren e punës që u miratua në Sesionin e Parë në Gjenevë.

MoP ka trupin ekzekutiv të saj, që është Byroja, e cila ka kryetar, dy zëvendës dhe katër anëtarë të palëve të Protokollit. Në punën e Byrosë si vëzhgues mund të marrin pjesë nga një përfaqësues nga organizatat joqeveritare mjedisore, si dhe nga industria. Kjo e drejtë aktualisht përdoret nga OJQ-të që marrin pjesë në punën e Byrosë me një nga përfaqësuesit e tyre.

Me përbërje të njejtë është edhe Grupi Punues i Palëve, por ai mbledhet më shpesh dhe ndjek zbatimin e Programit të Punës të Protokollit. Gjithashtu, Grupi Punues përgatit seancat e MoP, por gjithashtu merret me çështje të tjera teknike për zbatimin praktik të Protokollit, duke përfshirë hulumtimin e metodologjive për informacion, përgatitjen e udhëzimeve etj. Byroja e MoP gjithashtu shërben si Byro e Grupit të Punës.


Mbështetja e përgjithshme administrative e MoP, Grupit të Punës dhe Byrosë sigurohet nga Sekretariati. Ky rol në përputhje me Nenin 21 të Protokollit i jepet Sekretarit Ekzekutiv të KB EKE, ndërsa funksioni kryhet nëpërmjet Departamentit të Mjedisit.

Komiteti i harmonizimit është një organ ndihmës i MoP, i themeluar në përputhje me Nenin 22 të Protokollit, si një mekanizëm për rishikimin e harmonizimit të Palëve me Protokollin. Komisioni përbëhet nga gjashtë anëtarë, mandati i të cilëve zgjat mes tre seancave të njëpasnjëshme të MoP, por në çdo seancë, gjysma e anëtarëve zgjidhen / zëvendësohen.

Anëtarët e këtij Komiteti shërbejnë me kapacitetin e tyre personal, por jo si përfaqësues të Palëve të Protokollit. Në mënyrë të ngjashme, si me Konventën e Aarhusit, përveç paraqitjeve nga Palët dhe njoftimeve nga Sekretariati, secili anëtar i publikut mund të paraqesë njoftim në Komitetin për harmonizim në rastet e mospajtueshmërisë së ndonjë Pale me dispozitat e Protokollit.

GRAFIKU NR. 3.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E PROTOKOLLIT TË RSHTN



3. RSHTN DHE SHOQËRIA QYTETARE

Publiku i përgjithshëm është arsyeja pse janë miratuar Konventa e Aarhusit dhe Protokollin për RSHTN-në. Në këtë kontekst, publiku i përgjithshëm pritet të jetë korrektor i sjelljes së industrisë dhe autoriteteve. Për të kryer këtë funksion, publiku i përgjithshëm pret të informohet në kohë për shkarkimin e ndotësve.

Sistemet e RSHTN-së u japin autoriteteve informacion cilësor mbi burimet e ndotjes dhe emetimet e tyre, duke u lejuar autoriteteve kompetente të përcaktojnë prioritetet në uljen e rreziqeve dhe të marrin masa për të parandaluar dhe zvogëluar ndotjen. Këto sisteme gjithashtu shërbejnë si burime të dobishme informacioni përmes të cilave autoritetet kompetente mund të përmbushin detyrimet e tyre për informimin e publikut lidhur me ndotjen ose aktivitetet potenciale të rrezikshme.

Në anën tjetër, publiku, shoqatat mjedisore dhe qytetarët kanë në dispozicion të dhëna dhe informacione, të cilat u mundësojnë atyre të fillojnë dialogun me autoritetet kompetente, si dhe me operatorët ekonomikë, për të shqyrtuar mundësitë e zvogëlimit të rreziqeve për mjedisin dhe parandalimin e dëmeve për shëndetin dhe mjedisin.

Me fjalë të tjera, sistemet e RSHTN-së rrisin disponueshmërinë e informacioneve për mjedisin, promovojnë të drejtën e bashkësisë të njohë dhe të jetë e informuar për gjendjen e ndotjes në rrethin e saj, dhe u mundëson qytetarëve dhe OJQ-ve të ndërmarrin aktivitete dhe të marrin pjesë në vendimmarrjet për mjedisin jetësor me çka do të jenë të kufizuar këta ndotës ose aktivitetet potenciale ndotëse.

E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, këto sisteme ofrojnë kushte për forcimin e dialogut ndërmjet autoriteteve kompetente, industrisë dhe shoqërisë civile në mënyrë që të zvogëlohet ose shmanget ndotja dhe kështu të mbrohet mjedisi dhe shëndeti i popullatës.

3.1. Cili është fitimi i publikut nga ekzistimi i sistemeve të RSHTN-së?

Është e rëndësishme të kuptohet se njerëzit, qytetarët, të cilët përballen çdo ditë me rreziqe potenciale kimike, kanë të drejtë të dinë për ato rreziqe. Vetëm në një rast të tillë, publiku do të ketë kompetencë të ndikojë në vendimmarrje dhe vetë të marrë vendime të drejta dhe të ndërmarrë ose të kërkojë nga organet kompetente të ndërmarrin masa të duhura për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të tyre.

Nga ana tjetër, vetëm shoqëria civile e mirëinformuar dhe mirë e organizuar mund të përpiqet të ndihmojë autoritetet kompetente, por edhe industrinë, në proceset vendimmarrëse të mjedisit jetësor. Gjithashtu, punëtorët industrialë, si qytetarë, mund të marrin masa për mbrojtjen e tyre nga aksidentet apo fatkeqësitë e mundshme të shkaktuara nga substancat kimike, nëse janë të vetëdijshëm për pasojat mjedisore dhe pasojat për shëndetin e tyre.

Natyrisht, publiku i mirinformuar mund të ndihmojë shumë aktivitetet që synojnë përmirësimin e kushteve në mjedis, si dhe sigurinë dhe shëndetin e njerëzve.

3.2. Si mund të angazhohen OJQ-të në procesin e RSHTN-së?

Sektori i OJQ-ve është një pjesë e veçantë e publikut që vepron shumë më e organizuar dhe ka interes të marrë pjesë në proceset e zbatimit të Protokollit, të informohet me kohë për shkarkimin e ndotësve etj.

Pjesëmarrja e OJQ-ve, si eksponentë më të shquar të shoqërisë civile, mund të jetë e ndryshme. Përveç pjesëmarrjes në trupat punuese të Protokollit në nivel ndërkombëtar, ku aktivitetet e OJQ-ve janë të koordinuara nga Byroja Evropiane e Mjedisit dhe EKoForum, OJQ-të në Maqedoni gjithashtu mund dhe duhet të përfshihen në proceset e RSHTN-së.

Në fakt, komuniteti i OJQ-ve është përfshirë tashmë në procesin e regjistrave të ndotjeve në Maqedoni dhe përmes aktiviteteve të tyre është përshpejtuar në mënyrë të konsiderueshme procesi i ndërtimit të sistemit kombëtar. Në këtë kontekst, Qendra Rajonale e Mjedisit jetësor dhe OJQ-ja Qendra për demokraci ekologjike Florozon - Shkup në kuadër të disa projekteve pasuese ndihmuan në ngritjen e kapaciteteve për zhvillim të RTSHN-së në Maqedoni, duke përfshirë mbështetjen e MMJPH-së në përgatitjen e më shumë udhëzimeve për operatorët me instalime, me të cilat kjo çështje u afrohet faktorëve relevantë të RTSHN-së.

Kështu, për shembull, gjatë vitit 2015, OJQ Florozon nga Shkupi, në kuadrin e projektit "E Drejta për të Ditur", mbështeti në mënyrë aktive përgatitjen e Strategjisë për Zbatimin e Protokollit të RSHTN-së në Republikën e Maqedonisë. Ky dokument strategjik, duke respektuar dispozitat e Protokollit për pjesëmarrjen e shoqërisë civile, parashikon krijimin e një grupi punues koordinues për monitorimin

e Strategjisë së RSHTN-së (grafiku 4). Në atë grup punues, të cilin duhet ta formojë ministri i Mjedisit jetësor, përveç përfaqësuesve të organeve shtetërore, duhet të ketë një përfaqësues të komunitetit të OJQ-ve, i cili është aktiv në fushën e RSHTN-së dhe një përfaqësues i shoqërisë civile. Roli i grupit punues koordinativ është të monitorojë zbatimin e aktiviteteve të parapara në Planin aksional të strategjisë, të përgatisë raporte gjysmëvjetore për zbatimin e aktiviteteve dhe të propozojë aktivitetet korigjuese.

Sektori i OJQ-ve pritet të marrë pjesë me personelin e vet të kualifikuar në zbatimin e Strategjisë së RSHTN-së, për të ofruar mbështetje në informimin e publikut të gjerë dhe në promovimin e Protokollit.

Për këtë, është e nevojshme të sigurohen trajnime adekuate për përfaqësuesit e OJQ-ve, kualifikim shtesë i OJQ-ve të profilizuara që punojnë në fushën RSHTN-së, ndërtimin e partneriteteve ndërmjet autoriteteve dhe OJQ-ve, industrisë dhe OJQ-ve etj.

Përveç kësaj pjesëmarrjeje formale, OJQ-të mund të zbatojnë fushata të ndryshme për informimin e publikut për rëndësinë dhe përfitimet e RSHTN-së, si dhe aktivitete të ndryshme për edukimin mjedisor dhe informimin e sektorit joqeveritar dhe komuniteteve lokale. Ata gjithashtu mund të organizojnë ose të marrin pjesë në seminare, trajnime, punëtori, takime publike dhe tribuna tematike të lidhura me RSHTN-në. Ata mund të iniciojnë projekte të reja, të ofrojnë ekspertizë në fusha të caktuara dhe të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente në promovimin e të kuptuarit dhe përdorimit të informacionit nga sistemi RSHTN-së në komunitetin e tyre ose ndërmjet OJQ-ve.

Përfshirja aktive e OJQ-ve në proceset e RSHTN-së mund të ndihmojë shumë për të forcuar besimin në institucione, duke ofruar mbështetje ose ndihmë si "lehtësim" ose "urë" në komunikimin




Fotografia nr. 2 Përfaqësuesit e shoqërisë civile diskutojnë rolin e organizatave joqeveritare në zhvillimin dhe zbatimin e RSHTN-së në punëtorinë rajonale të mbajtur në Shkup nga data 8 deri më 9 nëntor 2016.

midis autoriteteve shtetërore ose lokale dhe industrisë ose qytetarëve. OJQ-të mund të kontribuojnë në aktivitetet në terren duke ndihmuar autoritetet kompetente përmes monitorimit aktiv dhe sinjalizimit në kohë të nevojës për të zgjidhur problemet e veçanta të ndotjes ose raportimit të RSHTN-së. OJQ-të gjithashtu mund të ndërmarrin aktivitete për të lobuar te autoritetet kompetente ose për të ushtruar presion ndaj tyre ose operatorëve, në rastet kur zbulojnë aktivitete të ndotjes që nuk lejohen ose tejkalojnë nivelet e lejuara, për të marrë masa për të zvogëluar ndotjen ose për ta parandaluar atë.

Natyrisht, OJQ-të munden dhe duhet të përfshihen në të gjitha proceset që kanë të bëjnë me ndërtimin ose përmirësimin e sistemit kombëtar të RSHTN-së në Maqedoni, në përgatitjen, miratimin dhe zbatimin aktiv në praktikë të akteve ligjore dhe nënligjore,

dokumentet strategjike, etj. Megjithatë, ata duhet të monitorojnë me kujdes procesin, të sigurojnë informacione të rregullta, të kërkojnë raportim të rregullt dhe përfshirje në aktivitete.

Me rëndësi të madhe është qëndrimi i drejtë i MMJPH-së, e cila është plotësisht e hapur për bashkëpunim me OJQ-të në ndërtimin e sistemit të RSHTN-së, që është veçanërisht evidente në dy apo tre vitet e fundit, kur pikërisht bashkëpunimi i ngushtë në zbatimin e sistemeve të ndryshme kombëtare dhe aktiviteteve dhe projekteve ndërkombëtare, intensifikon ndërtimin e sistemit të RSHTN-së në Maqedoni. Megjithatë, MMJPH duhet të vazhdojë të sigurojë informata të rregullta dhe të azhurnuara, por gjithashtu të përfshijë rregullisht OJQ-të në të gjitha aktivitetet që lidhen me sistemin e RSHTN-së.



4. SISTEMET E RSHTN-së TË BASHKIMIT EVROPIAN


Siç përshkruhet në fillim të këtij Udhëzuesi, idetë për RSHTN-në nuk kanë filluar me Protokollin e Kievit as nuk përfundojnë me të. Shumë vende kanë sistemet e tyre për RSHTN-në, të cilat nuk janë bërë në përputhje me Protokollin, por për Republikën e Maqedonisë me interes të veçantë është sistemi i RSHTN-së i Bashkimit Evropian, gjegjësisht Regjistri Evropian për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve, i quajtur E-PRTR.

Pse ky sistem është i rëndësishëm për Maqedoninë, nuk duhet të shpjegohet posaçërisht, duke pasur parasysh përcaktimin strategjik të shtetit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

E-PRTR është një regjistër i bazuar në internet, i themeluar me Rregulloren (EC) 166/2006,

me të cilin, në fakt, zbatohet Protokollin e Kievit për RSHTN-në, nënshkruesi i të cilit është Bashkimi Evropian (foto nr. 3). Rregullorja i detyron Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian të raportojnë në sistemin e E-PRTR, që e mban EEA, për burimet e ndotësve. Rregullorja përmban kërkesa të ngjashme me Protokollin e RSHTN-së, por megjithatë ekzistojnë disa dallime të vogla që do të përshkruhen më poshtë.

E-PRTR siguron të dhëna lehtësisht të disponueshme mjedisore, nga instalimet e industrisë në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, por edhe nga vendet që nuk janë anëtare të BE-së si Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Serbia dhe Zvicra, të cilat i dorëzojnë të dhënat



Fotografia nr.3 Faqja fillestare e E-PRTR

në bazë vullnetare. Regjistri përmbanë të dhëna që dorëzohen çdo vit nga mbi 30,000 instalime industriale për 65 lloje të aktiviteteve ekonomike në Evropë, duke përfshirë nëntë sektorë industrial (Grafiku nr.5).

Për secilin instalim, jepen informacione mbi sasi të ndotësve të shkarkuar në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për transferimin e mbeturinave dhe ndotësve në ujëra të ndotur, për gjithsej 91 ndotës kryesorë, të cilët bëjnë pjesë në shtatë grupet e mëposhtme :

- Gazrat serë
- Gazrat e tjera
- Metalet e rënda
- Pesticidet
- Materiet organike të kloruruara
- Materiet të tjera organike
- Materiet inorganike.

Numri i ndotësve të përfshirë në E-PRTR është një nga dallimet me Protokollin në Kiev, i cili në Shtojcën II numëron më pak ndotës, gjegjësisht gjithsej 86 ndotës.

Pesë ndotësit e shtuar në E-PRTR janë numëruar të fundit në listën e Shtojcës II të Rregullores së Bashkimit Evropian.

Siç nënvizohet nga Protokollin i RSHTN-së, E-PRTR përmban informacione mbi shkarkimet nga burimet e shpërndara, por në një masë të kufizuar, aq sa është praktike, edhe pse këto të dhëna janë vazhdimisht në rritje.

Në përputhje me kërkesat e Rregullores, të cilat në thelb janë identike me Protokollin, instalimi është i detyruar të raportojë të dhënat në E-PRTR, nëse i plotëson kriteret e mëposhtme:

- Instalimi zbaton të paktën një nga 65 aktivitetet ekonomike të renditura në Shtojcën I të Rregullores dhe tejkalon të paktën një nga pragjet e kapacitetit.
- Instalimi transferon mbetjet jashtë lokacionit, mbi pragjet e përcaktuara në nenin 5 të Rregullores.
- Instalimi lëshon ndotës në sasi mbi pragjet e përcaktuara për çdo medium-ajër, ujë dhe tokë - në Aneksin II të Rregullores.

Çdo instalim që është i detyruar të raportojë, ua dërgon të dhënat autoriteteve kompetente në baza vjetore. Pas mbledhjes së të dhënave, autoritetet kompetente kontrollojnë cilësinë e tyre dhe pastaj i dorëzojnë ato në Komisionin Evropian dhe Agjencinë Evropiane për Mjedisin (EEA), i cili i shpërndan ato përmes ueb faqes të E-PRTR.

Regjistri E-PRTR përmban të dhëna për shkarkimet dhe transmetimet e ndotësve nga 2007 në 2009, ndërsa nga viti 2011 të dhënat azhurnohen çdo vit, më së voni deri në muajin maj.

Agjencia Evropiane e Mjedisit është përgjegjëse për zbatimin e procesit të rishikimit të të dhënave cilësore, që bëhet në dy hapa.

Në hapin e parë, secili vend merr informacione të hollësishme mbi cilësinë e të dhënave të ofruara në E-PRTR.

Në hapin e dytë, të dhënat e E-PRTR krahasohen me të dhënat, të cilat shtetet ia dorëzojnë Konventës për ndotjen ndërkufitare të ajrit, Konventës kornizë të Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike dhe Sistemit të tregtisë me emetime të Bashkimit Evropian (për shkarkimet- në ajër), pastaj me të dhënat e dorëzuara në EUROSTAT dhe EEA (për mbeturinat dhe lëvizjet e vazhdueshme të mbeturinave), si dhe me të dhënat e dorëzuara në EEA dhe Sistemin e Informacionit të Evropës për ujëra (WISE) - (për shkarkimet në ujë).

Qëllimi i krahasimeve të tilla është identifikimi i pabarazive të mundshme midis të dhënave të publikuara sipas detyrimeve të ndryshme të raportimit, në bazë të të cilave vendet mund të korrigjojnë njoftimet e tyre nëse zbulohen gabime të caktuara.



4.1. E-PRTR dhe RSHTN i Kievit

E-PRTR është pasardhëse e ish-sistemit EPER të Bashkimit Evropian, i themeluar në korrik të vitit 2000, i cili, në fakt, nuk përfaqësonte një sistem të vërtetë të RSHTN-së meqë i mungonin disa karakteristika rëndësishme një sistemi të tillë. Shkaqet e ndryshimit të këtij sistemi me sistemin e ri E-PRTR, qëndrojnë në nevojën për një regjistër integral, si dhe detyrimin për të zbatuar Protokollin e RSHTN-së, nga Bashkësia Evropiane, si nënshkruese e tij. Protokollin e RSHTN-së përcaktoi detyrimet e Palëve të vendosin sisteme kombëtare të RSHTN-së, por me Rregulloren futet edhe një detyrim të ri për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për të informuar sistemin evropian për RSHTN-në për aktivitetet e përcaktuara dhe substancat.

Siç është cekur më lart, kërkesat minimale janë vendosur me Protokollin e RSHTN-së, por secila nga Palët ka mundësinë për të vendosur kushte më të rrepta për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të tyre të RSHTN-së.

Kjo është pikërisht ajo që është bërë me Rregulloren e KE-së (EC) 166/2006 e cila kërkon raportimin e pesë ndotësve shtesë (oktilfenolet dhe oktilfenol etoksilatet, fluorantinat, isodrin, heksabromobenzenil, benzo (g, h, i) perilenë. , Rregullorja gjithashtu vendos pragje më të rrepta për gjashtë ndotësit e tjerë: dioksinat (PCDD), furanët (PCDF), tetraklorilet, tetraklorometan, triklorobenzen, trikloretilen dhe triklorometan.

Por këto nuk janë dallimet e vetme ndërmjet Protokollit dhe Rregullores, të cilat për një numër më të madh të ndotësve përcaktojnë pragje më të rrepta për transferimin e ujërave të ndotura jashtë lokacionit.

Nga dy qasjet e ofruara me Protokollin (i cili është një marrëveshje globale ndërkombëtare në përputhje e sistemet e RSHTN-së),

për përcaktimin e detyrimit të raportimit, Rregullorja përdorë pragun e qasjes së kapacitetit të një instalimi të caktuar.

Në rastin e transportit të mbeturinave, megjithatë, E-PRTR përdorë qasjen e raportimit në bazë të sasisë së përgjithshme të mbetjeve të transportuara.

5. SISTEMI I RSHTN-së NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Republika e Maqedonisë, si palë e Protokollit të RSHTN-së, është e detyruar të krijojë dhe mbajë një sistem për raportimin e shkarkimeve dhe transferimin e ndotësve nga instalimet industriale në territorin e saj.

Në këtë kontekst, në nenin 42 të Ligjit për mjedis jetësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2005) është paraparë detyrimi për krijimin e sistemit të RSHTN-së, si pjesë e Kadastrit kombëtarë për mjedis jetësor. Më konkretisht, kjo çështje është rregulluar me miratimin e Rregullores për formën, përmbajtjen, metodologjinë dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve ("Gazeta zyrtare" nr. 27/2011), e cila hyn në fuqi më 1 janar 2013. Është e rëndësishme të theksohet se në këtë publikim Rregullorja e Bashkimit Evropian (EC) 166/2006 në pjesën më të madhe është transponuar në legjislacionin kombëtar, duke përfshirë edhe dy shtojcat e aktiviteteve dhe ndotësve.

Të dhënat dhe informacionet nga sistemi i RSHTN-së, në përputhje me kërkesat e Protokollit dhe Rregullores, duhet të ruhen në një bazë të dhënash relacionale të integruara, që nënkupton nevojën për një aplikim të programit elektronik të përshtatshëm (software), i cili do të mundësojë rrjetëzimin, përpunimin dhe shfaqjen e të dhënave nga Regjistri, mundësi për kërkim dhe qasje në Internet (duke përdorur një emër përdoruesi dhe fjalëkalim) dhe ruajtjen e të dhënave për një periudhë prej 10 vjetësh.

Sistemi elektronik maqedonas RSHTN (foto nr. 4) bazohet në softuerin e lirë që qeveria gjermane përmes

Agjencisë së saj Federale të mjedisit (UBA) ia ofroi Maqedonisë për zhvillimin e sistemit të saj RSHTN. Ky softuer, i quajtur gjerësisht BUBE, përshtatet me nevojat e Maqedonisë, në kuadër të dy projekteve të përmendura më lartë në 2.6.2.

Një përshkrim i detajuar i softuerit BUBE dhe mënyrës se si përdoren nga instalimet industriale, të cilat kanë detyrim të raportojnë, mund të gjenden në Udhëzuesin e përdoruesit për Regjistrin e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, të përgatitur në vitin 2015 nga OJQ-të Qendra për edukimin ekologjik Florozon, Shkup (Foto nr. 5).

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH) është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, të plota dhe të besueshme, si dhe për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së tyre, nëse kërkohet nga operatori i instalimit. Ministria gjithashtu kujdeset për besueshmërinë e të dhënave në sistemin e RSHTN-së.

MMJPH është gjithashtu një autoritet kompetent për ndarjen e të dhënave të përmbajtura në sistemin e RSHTN-së, gjegjësisht për njoftimin e publikut vendas dhe të marrëveshjeve dhe organizatave ndërkombëtare ndaj të cilave Maqedonia ka marrë detyrime.

Megjithatë, dhënia e të dhënave të plota, të azhuruara dhe të besueshme është megjithatë një detyrim i operatorit të çdo instalimi që kryen një ose më shumë nga 65 aktivitete të specifikuar në Shtojcën 1 të Rregullores, kur shuma e përgjithshme e shkarkimit të ndotësit individual çdo vit tejkalon pragun e përcaktuar në Shtojcën 2 të Rregullores, i cili rendit një total prej 91 ndotësve kryesorë, të cilët ndahen në shtatë grupe, me ç'rast sistemi kombëtar i Maqedonisë



Fotografia nr. 4. Faqja fillestare e online sistemit RSHTN të Maqedonisë (BUBE)

është identik me E-PRTR. Operatori është i detyruar që në fund të marsit të vitit aktual të paraqesë në MMJPH në formë elektronike dhe me shkrim të dhënat dhe informacionet e nevojshëm që kanë të bëjnë me vitin paraprak.

Gjithashtu, operatori është i detyruar të tregojë mënyrën e sigurimit të të dhënave dhe informacionit, gjegjësisht nëse ato janë pranuar me matje, llogaritje ose vlerësim.

I tërë procesi i njoftimit të operatorëve të instalimeve që duhet të raportojnë në përputhje me kërkesat e rregullores, është treguar dhe në detajisht është shpjeguar në raportimin të shkurtër për njoftim sipas Protokollit të RSHTN-së për instalimet në vend, të përgatitur në vitin 2013 nga Dr. Bosko Nikov, në kuadër të projektit "Ndërtimi kapaciteteve për aktivizimin e Konventës së Aarhusit dhe për të mbështetur zhvillimin e sistemeve të RTSHN-së në shtetet e Evropës Juglindore", zbatuar nga REC. Paraqitja skematike e paraqitjeve të përgjithshme të procesit të RSHTN-së është treguar në grafikun. 6. I definuar në këtë mënyrë,

sistemi i RSHTN-së në Republikën e Maqedonisë përmban të dhëna për:

- Instalimi me të gjitha impiantet në të dhe vendndodhja e saj gjeografike, përfshirë pellgun lumor në të cilin ndodhet
- Operatori i instalimit përgjegjës për dorëzimin e të dhënave
- Veprimtaritë e instalimeve
- shkarkimi i ndotësve në mediumet e mjedisit jetësor (ajër, ujë dhe tokë)
- krijimi dhe transferimi i mbeturinave larg nga lokacioni dhe pikë grumbullimi i tyre, sipas rastit dhe
- transferimet e ujërave të zeza jashtë lokacionit.

Në këtë moment, sistemi kombëtar i RSHTN-së ende nuk përmban të dhëna për burimet e shpërndara, të cilat planifikohen të përfshihen në sistem gjatë procesit të integritetit të shtetit në Bashkimin Evropian.


Електронски систем за известување на податоци за животната средина



Регистар на Испуштање и Пренос на Загадувачи
Pollutant Release and Transfer Register

Корисничко упатство

Fotografia nr. 5. Udhëzues i shfrytëzimit të Rregjistrit të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve



5.1. Ueb-portali kombëtar i RSHTN-së

Sidoqoftë, është më interesante për OJQ-të dhe publikun e gjerë në Maqedoni, natyrisht, se si të marrin të dhënat nga BUBE, gjegjësisht nga sistemi i RSHTN-së dhe për çfarë mund t'i përdorim këto të dhëna.

Për këtë qëllim, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ka zhvilluar një modul tjetër të veçantë nga ky softuer, i cili u dedikohet qytetarëve, OJQ-ve dhe publikut të gjerë.

Ky modul është faqja hyrëse e ueb-portalit për RSHTN-në (foto nr. 6).

Ueb-faqja është thjesht e strukturuar dhe mundëson marrjen e të dhënave të përgjithshme mbi RSHTN-në, rishikimin e raporteve relevante kombëtare, rishikimin e projekteve përkatëse dhe rregulloret ligjore, si në nivel ndërkombëtar ashtu edhe në vend. Pjesa kryesore e internetit është aftësia për të marrë dhe shfaqur të dhënat e ruajtura në bazën e të dhënave të sistemit të RSHTN-së, gjegjësisht shkarkimet dhe transferimet për të cilat operatorët kanë njoftuar nëpërmjet softuerit të RSHTN-së.


Kjo bazë të dhënash mund të kërkohet dhe të identifikohet sipas:

- Emrit të kapacitetit dhe zonës
- Vendit
- Kodit komunal
- Pellgut të lumit
- Grupit të substancave ndotëse
- Aktivitetit
- Substancave ndotëse


Në faqen e parë të ueb-portalit (Foto nr. 6), në anën e majtë ka një buton për lidhje (i cili do të aktivizohet në fazën përfundimtare të krijimit të ueb-faqes), me të cilën do të mund të formoni profilin tuaj personal në portal, i cili do t'ju mundësojë të keni qasje në shumë informacione

Formimi i profilit do të jetë falas dhe teknikisht i thjeshtë.

Në krye të faqes kryesore, vendosen disa meny rënëse, që përmbajnë lidhje me faqet e tjera. Në vazhdim në mënyrë tabelare janë paraqitur të gjitha menyte rënëse dhe përmbajtja e tyre.



Fotografia nr. 6. Faqja e parë e ueb-portalit të RSHTN-së në Republikën e Maqedonisë



Fotografia nr. 7. Harta e instalimeve që njoftojnë në sistemin BUBE për shkarkimet dhe transferimet e saj

EMËRTIMI I MENYSË RËNËSE	EMËRTIM I PËRMBAJTES SË MENYSË RËNËSE DHE NËN-MENY	PËRSHKRIMI SHKURTËR I UEB-FAQES	
FILLESTARE PËR RSHTN		Faqja e parë e ueb-internetit, ku përveç mesazhit të mirësearchjes, mund të lexoni lajmet më të fundit në lidhje me ngjarjet e lidhura me RSHTN-në në Maqedoni, por edhe jashtë vendit.	
	PROTOKOLLI I KIEVIT	Prezantim i shkurtër i qëllimeve kryesore të Protokollit të Kievit.	
	RSHTN NË R.M	Kjo faqe tregon sistemin e RSHTN-së në Maqedoni, duke përfshirë përmbajtjen dhe aktivitetet për të cilat mbahen të dhëna, si dhe lidhjen me Rregulloren e RSHTN-së dhe Listën e substancave ndotëse.	
	LINQE TË DOBISHME	Kjo faqe përmban lidhje me disa portale kombëtare dhe ndërkombëtare dhe institucionet e RSHTN-së, duke përfshirë E-PRTR dhe BE EKE.	
	SHKARKIME	Në këtë link gjenden të gjitha dokumentet që lidhen me RSHTN-në dhe të njejtat mund të shkarkohen në mënyrë elektronike.	
INDUSTRIA	KËRKIME	Kjo faqe është në fakt faqja qendrore e informacionit përmes së cilës ju mund të merrni informata të ndryshme për shkarkimet dhe transferimet e ndotësve nga instalimet industriale në Maqedoni <ul style="list-style-type: none"> • uzina dhe vendndodhja e saj gjeografike; përfshirë pellgun e lumit; • aktiviteti; • lirim e ndotësve në mediat e mjedisit (ajër, ujë dhe tokë); • transferimi i mbeturinave larg nga lokacioni në vend të caktuar dhe të përshtatshëm; • transferimi i ndotësve në ujërat e ndotur jashtë lokacionit; 	
	HARTA (FOTO NR. 6)	Një faqe shumë e dobishme në të cilën përmes "Google Maps" janë futur lokacionet e instalimeve industriale që janë të pranishme në bazën e të dhënave. Duke klikuar mbi simbolin e duhur do të gjeni emrin e instalimit, por është gjithashtu një lidhje me faqen speciale për atë instalim, ku mund të gjenden më shumë informacione.	
	RSHTN - ONLINE	Kjo faqe, është dedikuar për instalimet industriale, gjegjësisht për operatorët, të cilët prej këtu mund të kenë qasje në mjetin për informim online i ashtuquajtur RSHTN online.	
	STATISTIKA E RSHTN	Të dhënat statistikore për RSHTN-në.	
	NDOTËSIT	Faqe jashtëzakonisht informative për të gjitha substancat ndotëse që janë pjesë e sistemit RSHTN-së të Maqedonisë. Për secilën substancë (duke klikuar mbi emrin e saj), mund të zbuloni pragjet për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe karakteristikat e saj, përdorimin dhe ndikimin ndaj mjedisit jetësor dhe të ngjashme.	
	PBSH/ FAQ	Pyetjet e bëra më shpesh me RSHTN	
	INFORMACIONE	PROJEKTE	Këto faqejanë dedikuar për vendosjen e informacioneve lidhur me zbatimin e projekteve të RSHTN-së, të cilat financohen nga fondet vendase ose të huaja.
		RISI	Megjithëse lajmet e fundit rreth ngjarjeve të RSHTN-së në Maqedoni dhe jashtë vendit mund të shihen në faqen e parë, në këtë faqe mund të shihni tërë arkivin e informacioneve më të reja.
KONTAKT		Nëse, megjithatë, keni ndonjë pyetje në lidhje me RSHTN-në, ky është vendi i duhur për t'i shtruar dhe për t'ua dërguar ekspertëve të MMJPH-së, të cilët do t'ju përgjigjen sa më shpejt që të jetë e mundur.	
KËNDI I RSHTN-së	RSHTN - EDUKATIVE	Kjo pjesë përmban informacione dhe të dhëna të karakterit edukativ në lidhje me konceptet bazë dhe përkufizimet, si: ndotja, burimet e ndotjes, ndikimi i ndotjes ndaj mjedisit jetësor dhe shëndetit të njeriut për çdo substancë ndotëse individualisht.	
	MBETURINA-EDUKATIVE	Kjo pjesë përmban informacione dhe të dhëna të karakterit edukativ lidhur me mbeturinat e rrezikshme dhe të parrezikshme.	

6. INFORMACIONE DHE BURIME TË RËNDËSISHME

- Regjistri i shkarkimit dhe transferimit të ndotësve në Republikën e Maqedonisë

<http://prtr.moepp.gov.mk/>

- Ueb-portali për cilësinë e ajrit i MMJPH

<http://airquality.moepp.gov.mk/>

- UNECE - Kyiv Protocol on Pollutant Release and Transfer Registers

<http://www.unece.org/env/pp/prtr.html>

- BE EKE Protokolli i Kievit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve

UNITAR PRTR Platform

<http://prtr.unitar.org/site/home>

- Platforma RSHTN e Institutit për trajnim dhe hulumtim në KB

PRTR Global Portal

<http://www.prtr.net>

- Portali global i RSHTN-së

- European Pollutant Release and Transfer Register (E-PRTR) <http://prtr.ec.europa.eu/#/home>

- Rregjistri evropian i shkarkimit dhe transferimit të ndotësve (E-PRTR)

- European Commission's website on PRTR

<http://ec.europa.eu/environment/industry/stationary/eper/implementation.htm>

- Ueb-faqja e RSHTN-së e Komisioni evropian

- OECD Pollutant release and transfer register

<http://www.oecd.org/chemicalsafety/pollutant-release-transfer-register/>

Ueb-faqja e RSHTN e OECD

- Commission for Environmental Cooperation

- North American Pollutant Release and Transfer Register

<http://www.cec.org/tools-and-resources/taking-stock/taking-stock-online-north-american-industrial-pollution>

- Komisioni për bashkëpunim për mjedisin jetësor- RSHTN Amerika Veriore

- USA Toxics Release Inventory (TRI) Program

<https://www.epa.gov/toxics-release-inventory-tri-program>

- Programi i rregjistrimit të shkarkimeve helmuese të SHBA-së

Canada National Pollutant Release Inventory

<http://www.ec.gc.ca/inrp-npri/default.asp?lang=En&n=4A577BB9-1>

- Rregjistri kombëtar për shkarkim dhe transferim të ndotësve në Kanada

PRTR information plaza Japan

<http://www.env.go.jp/en/chemi/prtr/prtr.html>

- Sistemi informativ i RSHTN i Japonisë

- UNECE – Aarhus Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-making and Access to Justice in Environmental Matters

<http://www.unece.org/env/pp/introduction.html>

KB EKE - Konventa e Aarhusit për qasjen në informata, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje dhe qasja në drejtësi për çështjet mjedisore

- Support Establishment and Advancement of Pollutant Release and Transfer Registers (PRTRs) in Western Balkan Countries and in the Republic of Moldova

<http://aarhus.rec.org/prtr/index.html>

- Projekti për mbështetjen e krijimit

dhe zhvillimit të RSHTN-së në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë

- European Environmental Bureau, Federation of Environmental Citizens Organisations

<http://www.eeb.org/>

- Byroja ekologjike Evropiane, Federata e organizatave qytatare ekologjike

- EuropeanEcoForum, Pan-EuropeanCoalition of Environmental Citizens Organisations

<http://www.eco-forum.org/index.php/en/>

- EkoForumi Evropian, koalicioni Panevropian e organizatave qytatare ekologjike

7. LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA

EEA	Agjencia evropiane e Mjedisit
E-PRTR	Regjistri evropian i shkarkimit dhe transferimit të ndotësve
BE	Bashkimi Evropian
EJL	Evropa Juglindore
MMJPH	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
MoP	Takimi i Palëve
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
KB EKE	Komisioni Ekonomik për Evropën e Kombeve të Bashkuara
REC	Qendra Rajonale e Mjedisit
RSHTN	Regjistri i shkarkimit dhe transferimit të ndotësve
UBA	Agjencia federale e Mjedisit të Gjermanisë

8. LISTA E GRAFIKËVE, FOTOGRAFIVE DHE KORNIZAVE

Grafiku nr. 1	Rruga drejt Protokollit të Kievit për RSHTN-në.....	7
Grafiku nr. 2.	Elementet e sistemeve të RSHTN-së.....	12
Grafiku nr. 3.	Struktura organizative e Protokollit të RSHTN-së.....[.....	15
Grafiku nr. 4.	Përbërja e Grupit punues koordinativ për monitorimin e zbatimit të Strategjisë së RSHTN-së	19
Grafiku nr. 5.	Sektorët dhe aktivitetet industriale, të cilat janë të detyruara të raportojnë në E-PRTR	21
Grafiku nr. 6.	Prezantimi skematik i procesit të RSHTN-së në Republikën e Maqedonisë.....	26
Foto nr. 1.	MoP Konventa e Aarhusit dhe MoP-2RSHTN, Mاستriht, 2014.	14
Foto nr. 2.	Përfaqësuesit e shoqërisë civile diskutojnë për rolin e OJQ-ve në zhvillimin dhe zbatimin e RSHTN-së në punëtorinë rajonale të mbajtur në Shkup nga data 8 deri më 9 nëntor 2016.....	18
Foto nr. 3.	Faqja e parë e E-PRTR	20
Foto nr. 4.	Faqja e parë e online sistemit të RSHTN në Maqedoni (BUBE).....	24
Foto nr. 5.	Udhëzuesi i përdorimit të Regjistrit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve.....	25
Foto nr. 6.	Faqja e parë e ueb-portalit për sistemin e RSHTN-së në Republikën e Maqedonisë.....	28
Foto nr. 7.	Harta e instalimeve që raportojnë në sistemin BUBE për shkarkimet dhe transmetimet e tij.....	28
Korniza nr. 1	Mbledhja dhe publikimi i informacionit mjedisor	8
Korniza nr. 2	Takimi i Palëve.....	9

